


H-32-93
to 96

GAQO BUSHAKA

TE
STANI NE
MAL



85H-32-93

85H-32-93

B. 96.

BIBLIOTEKA E MIKUT TË VOGËL TË LIBRIT

S.

GAOQ BUSHAKA

TE STANI
NË MAL

(Tregime për fëmijët e moshës
së mesme shkollore)

462

BIBLIOTEKA E SHETËRI

GJURMASI 40400

SHETËRIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»

TE STANI NË MAL

Pali i vogël me krrabën e gjatë në dorë i futi dhitë në tendën e mbuluar me fletë fieri. Pastaj ndezi zjarrin dhe vuri të ziente ca qumësht. Në prag të tendës u shtri Balua dhe po dremiste. Pali kishte mbetur vetëm në stan, të jatin e kishin ftuar në mbledhjen e blegtorëve të dalluar. Çdo verë, kur mbaronte shkolla, Pali i ndihmonte të jatit në stan. Ai i donte me gjithë shpirt bagëtitë. Qielli i mbuluar me re të zeza gjëmonte. Era fishkëllinte me një zë të mprehtë dhe godiste pishat rrënjëthella që s'donin t'ja dinin nga goditjet e saj. Që nga stani fshati nuk dukej. Befas filloi të bjerë një shi i rrëmbyeshëm. Pali filloi të hante darkën, kurse Balua, kafshonte me shije një kockë të madhe. Vetëtimat formonin gjarpërinj të zjarrtë në fushën e errët të qiellit.

— A don miq, o i zoti i stanit! — u dëgjua një zë nga jashtë.

— Urdhëroni, — thirri Pali dhe brofi në këmbë.

Në tendë hynë dy burra të veshur keq.

— Jemi sharraxhinj, — thanë ata, — na zuri ky i mallkuar shi dhe erdhëm këtu sa të pushojë.

— Mirë bëtë, po urdhëroni të hamë.

— Po ty s'të del për vehte ajo që ke aty.

— Mos u mërzitni, unë kam plot qumësht, djathë, dhallë.

Dhe Pali u vuri të hanë, kurse vetë filloi të gdhente një lugë druri me bilbil. Ata hanin me aq uri, sa dukej sikur kishin një vit pa ngrënë.

— Pse të hanë kaq të uritur? — mendonte Pali. — Malësorët kanë boll bukë dhe nuk ja kursejnë asnjëriut — dhe nuk ua ndante vështrimin.

Por më tepër i mbetën sytë te një çantë e madhe e zezë që mbante njeri prej tyre në gjunjë.

— S'kam parë gjë më sot sharrëxhi me çantë të tillë.

Kështu mendonte Pali me vehte dhe vazhdonte të gdhente lugën e drunjtë me bilbil. Njeri nga ata fshiu buzët e ndotura me qumësht dhe i tha Palit:

— Vetëm paske mbetur sonte?

— Po. Pres të më vijë një shok, po si duket u vonua nga shiu.

— Nuk qenka malësor trim ay shoku yt. Ai duhet të vinte edhe në mes të shiut dhe të mos e linte shokun vetëm, — i tha njeri nga «mysafirët» Palit.

— Po në mes të këtij shiu është e vështirë të ecësh.

— Pse, mos vallë rojet në kufi e braktisin kufirin në kohë të tillë? — pyeti me djallëzi burri i parruar.

— Shoku im është i vogël, jemi moshatarë — i tha Pali, — po kur të rritemi dhe të ruajmë kufitë e vendit edhe ne si kufitarët tanë trima, nuk do tundemi nga vendi, jo prej shiut po as prej breshërit të plumbave të armikut.

— Ke qënë ndonjëherë te kufitarët?

— Kam qënë disa herë, edhe ata kanë ardhur shpesh në stanin tonë.

Burri i parruar ja nguli sytë me tmerr shokut të tij.

— Pra posta e kufirit qenka këtu afër?

— Është nja dy orë në këmbë, — tha Pali me djallëzi e u ngrit, bëri sikur kërkoi diçka pas derës dhe mbajti vesh.

— Do na ketë gënjyer ai malësori që na

tha se kufiri që këtej mban gjashtë orë, —
thoshin ndërmjet tyre.

Këta janë diversantë, tha me vete Pali.
Nuk duhet të na shpëtojnë. Po si të lajmëroj
shokët e këshillit?

Shiu vazhdonte të binte me furi. Rrë-
ketë e shumta zbrisnin me vrull nga mali.
Palit diç i shkrepiti në kokë dhe fytyra i qeshi
si ditë e bukur maji. Nxori nga xhepi një
copë letër, një laps dhe shkroi:

Te stani kanë ardhur dy diversantë.
Lajmëro kryetarin e këshillit

— Pali —

E mbështolli letrën mirë me një copë
leckë dhe ja vuri kalit në qafë, pastaj i thi-
rri:

— Hya! në shtëpi, në fshat.

Kali mezi u ngrit nga vendi, u shkryth
një herë dhe u nis për në fshat. Kali i Palit
ishite mësuar të shkonte shpesh herë vetëm
nga stani në shtëpi. Kur kali nuk dukej më,
Pali u fut në tendë. Të dy burrat e mbyl-
llën shpejt çantën e zezë.

— E, po pushon shiu?

— Jo ende, po ju mos u mërzitni o bu-
rra, këtu jeni si në shtëpinë tuaj. Shtëpia e
malësorit është shtëpia e mikut.



— Qenke qerrata i madh, — i tha njeri nga ata Palit me të qeshur.

«Mos vallë më kanë diktuar? — mendonte Pali me vehte. «Po sikur kali mos të shkojë në shtëpi, ose nëna mos ta verë re letrën e varur në qafë?»

Këto pyetje e mundonin. Shiu vazhdonte të binte, ndërsa Pali priste në ankth. Fytyra i qe skuqur sikur kishte ethe. Ai vazhdonte të gdhëndte lugën e drunjtë. Kaluan plot dy orë gjersa shiu pushoi.

— Hajde, Hajdar, — i tha njeri nga burrat shokut të tij. — Shiu pushoi.

Hajdari u shkryth pak dhe filloi të mba-thë këpucët që i kishte vënë për t'u tharë pranë zjarrit.

Eh, sa u vonuan, ziente Pali përbrenda. Do të më shpëtojnë. Si t'ja bëj?

— Hajt, mirë mbeç, — i thanë ata Palit dhe u bënë gati të delnin nga dera.

Pali sa s'po pëlciste nga ankthi. Donte si e si t'i mbante edhe ca.

Vriste mendjen të gjente ndonjë shkak për t'i kthyer në tendë.

— Do të bënit mirë të merrnit një sy gjumë, para se të shkonit — u tha ai.

— Jo, jo, n'asnjë mënyrë. Ne jemi sha-

rraxhinj e s'na pret puna — ja ktheu Tahiri e hapi derën të dilte.

Atë çast, si të kishin rënë nga qielli, në tendë u futën pesë malësorë me pushkë në dorë dhe thirrën:

— Dorëzohuni!

Të dy burrat mbetën të hutuar. Njeri deshi të rrëmbente diçka nga çanta e zezë, po Pali i ra çantës shpejt me këmbë. Nga çanta u derdhën fishekë, bomba, dy revolvera dhe një tufë kartmonedhash. Diversantët i lidhën. Ata e shikonin me urrejtje pionierin e vogël malësor që i zuri në kurth. Bashkë me malësorët kishte ardhur dhe i ati i Palit. At e bir u përçafuan. Malësorët i shtrënguan dorën me radhë Palit, ashtu si ja shtrëngon burri burrit, ndërsa kryetari i këshillit i tha:

— Të lumtë Pali, na e zbardhe faqen.

— Unë bëj ashtu siç më ka mësuar Partia dhe babai, shoku Zef, — tha Pali me kërenari. Çdo diversant kështu do ta pësojë tek ne.

Pastaj malësorët i vunë diversantët përpara dhe u nisën për në qytet. Pali u shkonte pas.

Shi nuk binte më. Frynte një erë e ftohtë. Në qiellin ngjyrë plumbi ishte formuar një ylber i madh. —

DINAMITI

Aliu ishte partizani më i vogël në çetë; ai sapo kishte mbushur të pesëmbëdhjetat. Kish-te një fytyrë të rrumbullakët dhe dy sy të kaltër si deti i qetë. Atë e thërrisnin Gavrosh. Kështu po e quajmë edhe ne. Gavroshi, si në luftime ashtu edhe në pushime, nuk ndahej asnjë çast nga Asllani, një partizan i ri, trupmadh që këndonte bukur. Asllani u kallte datën italianëve sa herë që binte në përpjekje me ta. Një herë ai erdhi me fytyrë të ngrysur dhe u ul pranë Gavroshit.

— Asllan, përse je kaq i mërzhitur sonte?

— Eh, na duhet ca dinamit për të hedhur në erë atë urën që të shpie në fshatin K po ku ta gjejmë? Kemi dy ditë që po vrasim mëndjen.

Gavroshi ra në mendime.

Në qiell hëna hiqej zvarë mes yjeve të rradhitur si gjerdan i zjarrit. Shumica e partizanëve ishin grumbulluar rreth një zjarri të

madh dhe këndonin këngë trimash. Disa partizane arnonin rrobat e shokëve nën dritën e kuqe të flakës që e luhaste era e lodhur e mbrëmjes.

Papritur Gavroshi thirri:

— Asllan, do të të sjell unë dinamit.

— Ti? — pyeti i habitur Asllani.

— Po, unë. Ti e di që jam nga ai fshat dhe e njoh mirë vendin ku e mbajnë italianët dinamitin. Kemi marrë një herë me Xha Sami-un. Qe shumë sa s'mund ta mbanim dot.

Dhe ata shkuan të dy te komisari.

Të nesërmen Gavroshi, i veshur me një palë pantallona të çjerra dhe me një këmi-shë tërë arna, u fut në fshat. Në duar mbante një pulë dhe një shportë të vogël me vezë. Iu afrua shtëpisë ku kishin qendrën italianët. Gavroshi e dinte se dinamitin italianët e mbanin në bodrumin e shtëpisë. Po si të futej gjer atje?

Kur u afrua pranë portës filloi të thërriste: Hajde pula, vezë... pula, vezë...

Roja e pa dhe ja bëri me shenjë që të afrohej.

— Sa i ke...

— I ndrroj me bukë.

Aty u grumbulluan edhe mjaft ushtarë

të tjerë dhe e futën Gavroshin në oborrin e shtëpisë. Ja muarrën të gjitha vezët dhe pulën, po bukë nuk i dhanë. Gavroshi sillej nëpër oborrin e shtëpisë, kërkonte bukë dhe shikonte me bisht të syrit dritaren e thyer të bodrumit.

— Këtej hyhet kollaj, — tha me vehte, — po si t'ja bëj që të rri këtu gjer sa të erret?

Në portën e shtëpisë u dëgjua boria e një makine. Prej andej doli një oficer madhor italian. Gavroshi vazhdonte të kërkonte me zë të lartë ose t'i jepnin bukë, ose t'i kthenin pulën dhe vezët. Kur pa oficerin në portë, një ushtar e kapi prej krahu Gavroshin dhe e mbylli në një dhomë. Atje Gavroshi ndenji deri sa u err mirë. Pastaj ngadalë, doli nga dhoma dhe eci në majë të gishtrinjve nëpër një koridor të gjatë, të errët gjersa doli në oborr. Atje mbajti frymën të dëgjonte. Nuk kishte këmbë njeriu. Jashtë portës dëgjoheshin çapat e rënda të rojes që vinte poshtë e lart. Duke u mbështetur pas murit, u afrua te dritarja e thyer e bodrumit dhe u fut brënda. Nëpërmjet dritares, në bodrum, hynte drita e zbehtë e hënës. Gavroshi me ata gishtrinjtë e tij të hollë, hapi me mundim të madh kapakun e një arke dhe filloi të mbush-

te shportën me llokume dinamiti ngjyrë ka-
fe. Pastaj doli nga bodrumi dhe u zvarit gjer
te muri i mbrapmë i shtëpisë. Me shportën në
dhëmbë, u ngjit në mur dhe u hodh poshtë.
Me vrap u zhduk nëpër terr në drejtim të
shokëve. Udhëtoi gjer më të gdhirë me bar-
kun bosh pa u ndalur asgjëkund. Kur agi-
mi skuqi majën e malit, arriti në vëndin ku
ishte çeta. Partizanët e pritën me krahe hapur.
Asllani fluturoi nga gazi, kur Gavroshi i vu-
ri përpara shportën plot dinamit. E shtrën-
goi fort në kraharor me duart e tij të forta
gjer sa një partizan i thirri:

— Mjaft o Asllan, se ja more shpirtin
fare.

Të gjithë qeshën, bashkë me ta qeshi me
gjithë zemër edhe Gavroshi i lodhur.

Komisari i shtrëngoi dorën Gavroshit dhe
i tha Asllanit.

— Tani do ta festojmë si duhet përvjetorin
e themelimit të Partisë sonë Komuniste.

— Shoku komisar, unë po nisem te ura,
që tani.

— Mirë Asllan, udhë të mbarë! — i tha
komisari dhe e përqafoi me dashuri.

Në mbrëmje u dëgjua një gjëmim i tmerr-
shëm dhe flaka skuqi një anë të qiellit.

— Asllani e hodhi urën në erë — urra! . . .
urra! . . . — thërisnin të gëzuar partizanët.

— Rroftë Partia Komuniste Shqiptare!
Urra! . . .

Bashkë me ta thërriste me gjithë fuqinë e
gjoksit të tij edhe Gavrosi i vogël.

KALI IM

Atëhere isha dhjetë vjeç. Nëna më kishte pajtuar çirak te prifti i fshatit, At Vasili. Më binte bretku në punë tërë ditën e ditës. Qetësohesha vetëm në të perënduar të diellit, kur mbaroja punën dhe ulesha te bregu në fund të fshatit. Atje prisja nënën që kthehej nga ara me Kuqon, kalin tim. Një herë pashë Kuqon tim, me ato zilkat e vogla në qafë dhe nënën me shoqet e saj që vinin me shata në krahë nga xhadeja përtej lumit. Me vrap i dolta përpara, e kapa Kuqon nga freri dhe u nisa për në kalibe. Nga mali po zbrisnin dhritë dhe kecrit si një prrua i rrëmbyer malor. Kur arritëm në shtëpi mezi prita nënën që ta shkarkonte Kuqon, e kapa nga freri dhe e shpura për te krroi i ftohtë i fshatit. Sapo arritëm në krrua një tufë kecash e zunë korritën. Kuqua priti sa mbaruan ata dhe pastaj filloi të pinte me etje. Unë shikoja barkun e madh të kalit që ngrihej e ulej. Si u ngop mirë e mirë, i hypa kaluar dhe u nisa për në

shtëpi duke kënduar. Gjyshja i hodhi Kugos një thes me bar të njomë që e kishte mbledhur për të dhe e mbylli në katua. Ai përtypte barin plot lëng me nofullat e tij të fuqishme dhe unë kënaqesha duke e parë.

Të nesërmen ishte e djelë. U zgjova që me natë dhe vajta në shtëpinë e priftit. Ata nuk ishin ngritur akoma nga gjumi. Nisa të pres drutë që duheshin për mëngjes por, sa u ula në shkallë, dëgjova që dikush trokiste në portë. Ishte Petrua, një shoku im.

— U ngrit urata, Filip?

— Jo akoma, po ti pse ke ardhur?

— Nëna është e sëmurë dhe më dërgoi babai të marr një tas miell te urata, se s'kemi asnjë kothere bukë për t'i dhënë.

— E ku e le priftëresha të të japë, more derëzi.

— Unë do t'i them një herë.

Ndërkohë doli nga dera e hajatit priftëresha veshur me një fustan të bukur. Pas saj u duk dhe urata.

— Mirëmëngjes uratë, — i tha Petrua.

— Më ka dërguar babai të më japësh hua këtë tas me miell.

Prifti fërkoj një herë mjekrën dhe pa priftëreshën në sy.

— Ne s'kemi asnjë dorë miell, mor djalë,
— i tha ajo, — po shko gjetkë.

Petrua doli ngadalë nga porta kokëulur me tasin bosh. Më pikë në zemër për të. Befas diç më shkrepri në kokë. E ndoqa pas dhe e arrita.

— Shiko Petro, sa të ikë urata në kishë, ti eja këtu se të gjej unë meshë.

— Ku do t'i marrësh?

— Hajt ti se e di unë atë punë.

Priftëresha trembej aq shumë nga gjarpërinjtë, sa i binte të fikët. Një ditë më parë unë kisha vrarë një gjarpër anës gardhit. Vajta e mora dhe e fsheha nën dru. Kur iku urata, Petrua erdhi me një frymë.

— Prit këtu, Petro.

E mora gjarpërin dhe e vura mu në vëndin ku priftëresha hante mëngjesin. Ajo nuk qe aty. Kur erdhi dhe e pa ulëriti sikur i ra pika. Gjarpëri iu duk si i gjallë.

— Ç'ke moj zonjë, — e pyeta unë si i shqetësuar.

Ua! një gjarpër mu te vëndi im; aman vraje se po vdes!...

— Nëm dy meshë zonjë dhe e vras unë fët e fët.

Ajo vajti të merrte meshët, ndërsa unë

462 .

17

IBRITËKKA E SHITËNA

GJURHASIM 470400

rrëmbeva një shkop dhe e hodha te plehrat gjarpërin e ngordhur.

Kur u kthye me meshët në dorë, priftëresha e kishte marrë ca vehten dhe sikur e kishte kuptuar dredhinë time.

— Ah, i paudhë, më duket se ti ma kishe vënë atë gjarpër; ndaj ke dalë shtatanik.

Atë ditë e mora vesh se paskësja lindur shtatanik.

Unë bëra be e rrufe që gjarpëri kishte ardhur vetë.

Në drekë prifti solli në shtëpi pesë gjermanë që kishin ardhur në fshat për të mbledhur kafshë. Kur e mora vesh këtë u bëra pik e vrer dhe vrapova me një frymë në shtëpi. Edhe aty gjeta dy ushtarë gjermanë. Gjyshja dhe nëna rrinin duarkryq në fund të shtëpisë së zjarrit. Pas pak erdhën edhe ata pesë gjermanët që hëngrën drekë te urata dhe hynë në katua. Ushtarët e morën nga freri Kuqon dhe e nxorën në oborr. Ata diç folën ndërmjet tyre me një gjuhë të huaj që nuk e kuptoja.

— Amani, — u lutej gjyshja, — mos na e merrni se me atë ushqehemi të gjithë.

Një ushtar e shtyu gjyshen dhe ajo u rrëzua në kalldrëm. Unë u hodha duke qarë



mbi gjyshen. Nëna rrinte si e mpirë. Kuqua ktheu kokën nga ne dhe një pikë loti i varej nga syri i majtë. Kur oficeri e tërhoqi me forcë nga freri, Kuqua e qëlloi me shkelm në koishë. Oficeri gati u rrëzua dhe xhami që mbante në njerin sy iu bë copë-copë. Atëhere ushtarët e kapën Kuqon për freri dhe filluan t'i binin me kamxhik. Ai hingëllinte sikur kërkonte ndihmën tonë. Më dukej sikur më binin mua me kamxhik dhe kafshoja buzën nga dhëmbja. Pasi e rrahën mirë e mirë, e morën me vete. Unë, gjyshja dhe nëna u futëm brenda, shtëpia na dukej e zyrtë, sikur të kishte ndodhur ndonjë vdekje. Rashë të flija herët po gjumi nuk më zinte. Më dilte gjithnjë përpara koka e madhe e Kuqos tim me ato zilkat e vogla. Në mes të natës dikush trokiti me forcë në portë. U ngritëm me gjyshen, hapëm portën dhe mbetëm shtang në vënd. Kuqua im kishte ardhur prapë. E putha ku munda, ndërsa gjyshja i fshinte me futë vithet e djersitura. Atë natë rashë të flija në oborr, ndën mbulesën pikalore të qiellit të qëndisur me yje që shkëlqenin. Të nesërmen e mora vesh se si qe puna që kali im qe kthyer. Partizanët u kishin zënë pritë gjermanëve dhe i kishin shpartalluar. Ushtari që i kishte hipur Kuqos ishte vrarë. Kuqua nuk

kishte pritur më, po me vrap ishte kthyer në shtëpi.

Atë ditë fshati u çlirua nga forcat partizane, kështu që Kuqon nuk e ngau më njeri me dorë. Nga mali së bashku me partizanët u kthye edhe babai im me vëllanë që kishin dalë edhe ata partizanë. U tregova historinë e Kuqos. Që atëhere fillova të shkoj në shkollë dhe nuk punova më si çirak në shtëpinë e priftit.

GJAK NË DËBORË

Atë mëngjes sirenat nuk fishkëlyen si gjithmonë. Asnjë punëtor nuk doli në punë. Bënte ftohtë. Shkopinj të akullt vareshin nga pullazet e shtëpive. Dëbora kishte zbardhur rrugët e Kuçovës plakë. Babai u ngrit me rrëmbim, hodhi një pallto të vjetër në krahe dhe vështroi nga dritarja sheshin e vogël, para rafinerisë së naftës, që kishte mbetur shkretë.

— Asnjë s'po del, — murmuriti dhe filloi të thithë në heshtje tymin e një cigareje të trashë.

Unë nxora kokën nga jorgani dhe i thashë nënës me zë të ulët:

— Nënë, përse babai sot nuk po shkon në punë? Mos është gjë sëmurë?

— Jo mor bir, sot punëtorët do të bëjnë grevë.

— Grevë?! — pyeta unë i habitur, po ç'do të thotë kjo, moj nënë?

— Ata do të kërkojnë t'u ngrihet rroga, se ripen tërë ditën në punë dhe nuk marrin gjë prej gjëje.

— A të shkoj edhe unë me babanë, moj nënë?

— Jo bir, xhandarët mund të shtien kundër tyre dhe ruajna o zot e më pëson gjë.

— Po babai nuk të dhimbet?

— Ai është burrë dhe di se si të mbrohet, pastaj, sido që të jetë, nuk mund të ndahet nga shokët.

Pas pak babai u vesh dhe doli. Pas tij dola dhe unë dhe vrapova në shtëpinë e Nuriut. Rrugët kishin mbetur shkretë. Qyteti dukej si i mbështjellë me një savan të bardhë. Tymi i hollë që dilte nga oxhakët tretej shpejt në gjirin e qiellit të ftohtë.

Nuriun e gjeta duke ushqyer pëllumbat e tij.

E përshëndeta dhe u afrova të shikoja si i ushqente. Ata çukisnin me sqepat e tyre të verdhë bukën e thërmuar mbi dëborë dhe bënin: Gu-gu... Gu-gu... .

— Shiko Cen, dje ky pëllumbi këtu me atë koçlycin këmbëlesh rrëmbyen një çift pëllumbash; shiko sa të mirë që janë.

— Të kujt të jenë vallë?

— Ku ta dish? Do t'i kisha kthyer tek i zoti, po ta dija. A do të të jap edhe ty një çift pullumbash?

— Dua, po nuk më le nëna.

— Mirë, si të kesh dëshirë.

— Dëgjo Nuri, sot do të bëhet grevë.

— E di. Do të dalim edhe ne të dy dhe do të bërtasim kundra atyre zotrinjve italianë. Po na qëlluan xhandarët, do të t'u biem edhe ne. Edhe mbreti është me ta. Por punëtorët s'duan t'ja dinë. Sa bukur fliste Nuriu, shoku im më i ngushtë! Ai ishte dy vjet më i madh se unë. Të dy venim në shkollë, të dy luanim. Shpesh Nuriu vinte për drekë tek ne se nëna dhe babai e donin shumë. I ati i Nuriut vuante nga tuberkulozi. Ai nuk punonte po merrte një pension të vogël, ndërsa e ëma nuk gjente dot punë. Atë kohë ishte e pamundur të gjendej punë për nënat tona.

Bashkë me Nuriun zbritëm në kopshtin e madh të braktisur të një nëpunësi të rafinerisë dhe filluam të mbledhnim degët e thata të pemëve. Mbasi bëmë nga një krah të mirë, u kthyem në shtëpinë e Nuriut. Xha Idrizi, babai i Nuriut, ishte ngritur për gjysëm në shtrat dhe kollitej. Në dhomë bënte ftohtë.

— Mirë mëngjes, xha Idriz.

— Mirë mëngjes, bir.

Në dhomë hyri edhe nëna e Nuriut me një tas plot mëmëlige me miell të misërt. Hëngru edhe unë me ta. Pastaj dolëm nga shtëpia dhe u nisëm me vrap drejt sheshit të vogël përpara rafinerisë. Qyteti kishte filluar të gjallërohej. Kur arritëm te sheshi, pamë një grumbull të madh punëtorësh me fytyra të zymta.

— Erdhi koha për t'u rënë sirenave, — foli dikush nga balli i turmës, kur arritën përpara shtyllës së sirenave.

Njëri nga punëtorët, u ngjiti lart duke ngulur gozhda në shtyllë.

— Hë dhe pak Xhavit, dhe pak, — i jepnin zemër punëtorët nga poshtë.

Fishkëllima e sirenave çau ajrin e ftohtë të atij mëngjesi. Një e ngjethur më përshkoi trupin.

Punëtorë të tjerë filluan të bashkoheshin me turmën ku isha futur edhe unë me Nuriun.

— Xhandarët! — thirri dikush.

Nga fundi i rrugës, u duk një grup i madh xhandarësh, të cilët i dolën përpara turmës së punëtorëve që shtrënguan radhët më fort.

Mua dhe Nuriut na rrihte zemra me forcë, megjithatë ecnim me hapin e sigurtë të baballarëve tanë. Pas pak komandanti i xhan-

dërmarisë, Et' hemi hypi në një vënd të ngritur dhe thirri:

— Ej, dëgjoni: shpërndahuni nëpër shtëpitë tuaja ose shkoni në punë. Ky është urdhëri i mbretit. Ndryshe do të përdorim forcën.

— Mbreti s'çan kokën për ne! — thirri dikush.

— Shpërndahuni! . . .

Po turma, në vënd që të shpërndahej, marshoi me guxim përpara. Atëhere filloi përleshja me xhandarët.

Unë dhe Nuriu në fillim mbetëm si të hutuar dhe shikonim të çqetësuar, duke kthyer kokën sa në një anë në tjetrën.

Në një cep të rrugës dy xhandarë kishin vënë për fund një punëtor dhe po i binin me kamxhik në kokë. Punëtori ngrinte duart për t'u mbrojtur por më kot. Ndërkaq Nuriu u sul me vrap dhe u hodh mbi njerin nga xhandarët. Unë rrëmbeva një copë druri të thyer dhe iu sula xhandarit tjetër. Punëtori me fytyrë të mavijosur u ngrit dhe filloi t'i qëllonte me grushta xhandarët.

— Nuri, po vij në xhandarë të tjerë — thirra unë.

U nisëm me vrap në drejtim të kundërt nga vinin forcat e xhandërmarisë. Ndërsa po

vraponim u dëgjua një krismë pushke. Nuriu u lëkund pak si një lule nga tufani i tërbuar dhe ra përmbys mbi dëborë.

— Nuri, Nuri, — i thirra sa munda po ai nuk fliste. Një gajtan i hollë gjaku i rridhte nga buza e tij e zbehtë dhe qëndiste dëborën e bardhë.

Rrëmuja vazhdonte. Punëtorët përlesheshin me xhandarët.

E tërhoqa zvarë Nuriun dhe e largova nga sheshi, i revoltuar.

Nuk i hiqja sytë nga fytyra e zbehtë e shokut tim.

— Nuri, Nuri, — i thirra, por më kot. Atëhere fillova të qaj me lot.

— Përse qan? — më pyeti me ngut një punëtor, por shtangu kur pa gjakun e kuq të shokut tim që nxirrte avull mbi dëborën e ftohtë.

E ngriti dhe me të në duar çau mes rrugëve të qytetit.

Njerëzit shikonin Nuriun e vogël të Xha Idrizit me kokë të varur mbi krahët e fortë të punëtorit. Unë e ndiqja pas si një hije e heshtur. E shpumë në shtëpi. Babai dhe nëna ranë duke ulëritur mbi trupin e njomë të të birit. Nuriu hapi pak sytë që i kishte si dy yj të

venitur mbi sfondin blu të qiellit dhe pëshpëriti:

— Ceni, më ki kujdes pëllumbat.

Shtëpia e vogël e Xha Idrizit u mbush me njerëz. Unë vrapova në shtëpi të lajmëroja nënën. Lotët më rridhnin çurkë nëpër faqe. Kur kalova pranë bashkisë së qytetit, pashë portretin e mbretit Zog, që ish kapardisur si maçoku në thekër, dhe buzëqeshte.

— Unë qaj, ai qesh, — thashë me vete. A, katil!... dhe rrëmbeva një gur e ja vërvita mu në kokë mbretit që buzëqeshte. Portreti ra për tokë. Unë ja mbatha për në shtëpi.

Dëbora e ftohtë vazhdonte të binte mbi shtëpitë dhe rrugët tashmë të heshtura të Kucovës plakë.

NË MES TË PYLLIT DHE DËBORËS

Kola një djalë katërmbëdhjetë vjeçar; mbylli portën e rënduar nga shiu që kishte rënë dhe hyri brenda në shtëpi.

I ati me mollëzat e faqeve të dala e të verdha dyllë, kollitej gjersa i merrej fryma. E ëma kishte vdekur para disa muajsh, nga tuberkulozi.

Kola mezi ndezi zjarrin në vatrën e lagur dhe vuri mbi të një tenxhere të vogël me ujë. Hapi dollapin se mos gjente ndonjë kothere bukë, po atje binte miu e thyente hundët, siç i thonë llafit. Tërë ditën kishte ngrënë vetëm gorica dhe i vinte të përzier.

Në mëngjez nuni erdhi mori babanë e sëmurë dhe e shpuri në qytet. Kola mbeti vetëm, u soll poshtë e lart fshatit pastaj shkoi në kishë. Fshatarët dëgjonin ungjillin dhe bënin kryq. Aty ishin dhe 4 gjermanë flokverdhë. Armët i kishin varur tek një shtog në oborr,

dhe ua ruante një shok i tyre. Një grua i dha Kolës një copë naforë dhe një dorë grurë të zier. Këto ja shtuan edhe më shumë urinë. Po ç'të bënte? I uritur u nis për në shtëpi. Portën e shtëpisë e gjeti të hapur.

— Do të ketë ardhur gruaja e nunit —
mendoi.

Kur hyri brenda pa Mitron një mik të babait, që ishte partizan, po kishte ardhur disa herë në shtëpi të tyre, i veshur si fshatar.

— Mitro! Si munde të vish, gjermanët janë nëpër fshat, katër prej tyre i pashë në kishë — i tha me frikë dhe iu hodh në qafë.

— Babai ku është?

— Ka vajtur me nunin në qytet, është i sëmurë.

— Sonte do të shkoj në fshatin K. . . të çoj një letër të fshehtë por dua të vish edhe ti me mua se i di mirë shtigjet.

— Po si jo, ore — i tha Kola dhe sytë i shkëlqyen nga gazi.

Qielli kishte marrë një si ngjyrë plumbi. Bënte ftohtë. Në të ngrysur filloi të binte dëborë.

Kur u err mirë, Kola dhe Mitrua dolën nga shtëpia. Era ua përplaste dëborën në fytyrë. Në errësirën e thellë nuk dallohej as-

gjë. Kola i njihte mirë shtigjet dhe u kaluan nën hundë gjermanëve. Mitrua e ndiqte pas dhe herë-herë fuste dorën në gji të kontrollonte letrën. Udhëtuan dy orë të mira dhe më në fund arritën. Në një kasolle buzë lumit ishte komisari së bashku me disa partizanë të tjerë. E përqafuan Mitron dhe Kolën, pastaj komisari dhe Mitrua filluan të bisedonin në një cep të dhomës së shtruar me baltë. Partizanët e tjerë e pyesnin Kolën për gjendjen në fshat.

— Kolë! — i thirri Mitrua, eja të nisemi.

— Nuk do të flemë sonte këtu?

— Në ke të ftohtë dhe je lodhur rri, po mua më duhet të kthehem sonte pa tjetër në çetë, te shokët.

— Unë s'dua t'ja di as nga lodhja as nga të ftohtët ja ktheu djali.

Kola dhe Mitrua u nisën përsëri në mes të furtunës. Era çirrej si e marrë. Shtëllunga dëbore u përplaseshin në fytyrë. Këmbët u futeshin në dëborën e butë. Kur, pa pritur, dikush u thirri në gjuhë të huaj:

— Alt!

— Vrapo Kolë, gjermanët! — thirri Mi-



trua me zë të ulët, po fjalën ja preu një batare automatiku.

— Më plagosën, djalli ta marrë, ikë ti Kolë ikë. Unë nuk eci dot, më kanë plagosur në kofshë, ikë... ikë!

Po Kola nuk iku, filloi ta tërhiqte zvarrë Mitron nëpër dëborë. Eci kështu gjersa gishtrinjtë iu mpinë. U ul në një trung dushku dhe filloi t'i ngrohëte me frymë gishtrinjtë e mpirë. Mitrua kishte humbur ndjenjat. Kapelja me yll të kuq i kishte rënë mbi gjoks. Kola ja mori dhe e futi në gji. U mundua ta ngrinte Mitron po nuk mundi dhe filloi ta tërhiqte përsëri. Këmbët nuk i ndjente, po gjithë hallin e kishte te gishtrinjtë.

«Mbahuni dhe ca!» — u thoshte gishtrinjve dhe vazhonte rrugën.

Era përplasej me furi mbi drurët e pyllit dhe ulurinte si një bishë e egër e plagosur. Dëbora filloi të rrallohej. Djali 14 vjeçar luf-tonte për jetë a vdekje, mes pyllit dhe dëborës.

— Unë do ta çoj Mitron te shokët, patjetër do ta çoj, mendonte me vehte dhe vazhdonte të tërhiqte trupin e ngrirë të partizanit. Më në fund u këput e ra mbi dëborë,

pranë Mitros. U përpoq të ngrihej po nuk mundi dhe i humbi ndjenjat; megjithatë dorën nuk e hoqi nga dora e Mitros, sikur trembej mos ja rrëmbente njeri.

Të nesërmen Kola u gjend në një shpellë të vogël të ngrohtë. Kur hapi sytë, pa rreth vetes një grumbull partizanësh që e shikonin me dashamirësi.

Komandanti e përqafoi, ai i tregoi Kolës, që rrinte si i shastisur se si partizani — roje e kishte parë së largu. Menjëherë pesë partizanë kishin vrapuar drejt tyre dhe i kishin marrë. Në gji të Kolës kishin gjetur dhe kapelen e Mitros me yll të kuq.

— Çeta dhe Mitrua shpëtuan në saje të guximit tënd, djalosh i tha komandanti. Kola ndenji tri ditë me partizanët, pastaj u kthye në fshat. Babanë e gjeti tek priste i mërzhitur mbi sofatin e portës. Kola iu hodh në qafë dhe me një frymë i tregoi ç'i kishte ndodhur.

At' e bir të shtrënguar pas njeri tjetrit, u futën në shtëpi.

BARIU I VOGËL DHE KAÇAKËT

Bulin e vogël e kishte pajtuar i ati të ruante dhitë e beut. Buli kishte shtat të pakët dhe një fytyrë të hequr. Në faqe sa herë qeshte i shquheshin dy gropëza të vogla e të bukura. Por ai qeshte rrallë. Buli ngrihej që me natë, merrte një copë bukë misri e një qepë, i vinte në torbën e tij të vogël bashkë me fyellin dhe nisej me dhitë. Buli të magjepste kur i binte fyellit! Atë ças bilbilet e prisnin këngën e tyre, dhitë mblidheshin rreth tij dhe dukej sikur shikonin si i luante gishtrinjtë e hollë mbi kraharorin e shpuar të fyellit prej kallami, ndërsa Murua, qeni i tij qimegjatë, tundte bishtin dhe mbështeste kokën mbi gjunjët e bariut.

Një herë Buli i ktheu dhitë vonë në fshat dhe u shtri mbi kashtë, te një kënd i kasolles së tij. Pas pak atje vajti qahajai i beut, një burrë hundështypur me një palë mustaqe të mëdha, dhe i shfryu me inat:

— Ku e ke atë kecin pullali? Nuk e di, mor tutkun, se beu do ta therte sonte për meze, që të kënaqte mysafirët. Sa herë të kisha porositur që ta ruaje mirë. Hajd nisur e gjeje tani.

— Zoti Vasil, — i tha Buli me lotë në sy, tani është natë, në pyll ka egërsira. Pse nuk therni një kec tjetër, të gjithë të mirë janë.

— Nisur shpejt, qurrash, e mos më mëso mua! — ja ktheu qehajai dhe i ra me një pëllëmbë në faqe.

Bariu u ngrit pa bërë zë dhe u nis zbatthur në drejtim të pyllit. Murua e ndoqi pas.

— Hajde Muro, hajde xhan, oh, sa i mjerrë do të isha pa ty, — foli Buli dhe e pushtoi me të dy duart.

Të dy filluan të ecin në mes të pyllit të errët. Murua e ruante nga pas dhe lehte.

— Mos lih, Muro, se do të na dëgjojnë egërsirat dhe do të na shqyejnë. Por Murua vazhdonte të lihte sikur donte të tregonte se s'kishte frikë nga ato. Buli dhe Murua vazhdonin të kërkonin kecin pullali nëpër pyll. Shkurret dhe ferrat i gjakosnin llërët e çveshura Bulit, por ai vazhdonte të kërkonte kecin e humbur. Nga maja e lisave dukeshin yjet në qiell. Drita e hënës depërtonte nëpërmjet

degëve të hapura. Te një lëndinë e vogël në mes të pyllit, ku drita e zbehtë e hënës binte më mirë, Buli u ul.

— Muro, — i tha qenit, — unë po shlodhem një çikë. Shiko si më janë bërë këmbët, po të më zërë gjumi më zgjo.

Murua tundi kokën sikur e kuptoi gjuhën e bariut të vogël. Bulin e zuri gjumi shpejt nga lodhja, ndërsa Murua u ul mbi bisht dhe ruante. Ai nuk lihte më.

Buli shikonte në ëndër sikur vëllai i tij e vrau beun mu në mes të fshatit dhe tërë tokën e beut ua ndau fshatarëve. Atij i blenë një palë rrobe të reja dhe e dërguan të mësonte në shkollë. Buli qeshi në ëndër, kurse Murua ngriti veshët dhe u bë gati për sulm. Dy ujq të uritur iu sulën qenit, por ai nuk u tremb; përkundrazi, lehte me forcë që të zgjonte Bulin dhe u vërvit mbi egërsirat e uritura. Buli u zgjua i tmeruar dhe s'po dinte ç'të bënte. Atëkohë çau ajrin si një fishkëllimë e mprehtë krisma e një pushke. Ujqërit të tmerruar u larguan. Aty erdhën me vrap pesë burra të armatosur me mjekra të zeza. Këta burra kishin dalë malit kaçakë se ishin ngritur kundra qeverisë. Njeri nga ata mbante një këc në dorë.

— Mos u tremb vogëlush, — i thanë Buli, — ne jemi kaçakë. Ç'të ka sjellë në mes të natës këtu?

Buli u tregoi gjithçka.

— Ah, ai Vasil nepërka! — tha njeri nga kaçakët. — Do ta shikojë sonte me gjithë beun. Si të quajnë ty?

— Buli.

— Dëgjo Buli, — i tha kapedani i tyre, — sonte do të djegim sarajet e beut, mirëpo nuk dimë nga të futemi...

— Di unë një hyrje të fshehtë nga prapa sarajeve. Por... dua të gjej kecin.

— Mos është ky?

— Po! — thirri Buli i gëzuar, — ky është.

— Ja pra dhe kecin ta gjetëm, tani hajde me ne.

Buli mori me vehte edhe Muron e gjakosur që mezi ecte. Kaçakët ja lidhën plagët me një copë këmishë të grisur.

Kur hynë në fshat ora ishte një pas mesnate. Shtëpia e beut ziente nga këngët. Kaçakët kërcyen murin dhe u futën ndënë saraje te katoi ku beu mbante kashtën. I vunë flakën kashtës dhe u larguan. Buli hipi mbi një



rrap të lartë dhe që andej shikonte sarajet e beut që digjeshin. Nxori nga gjiri fyellin e tij dhe filloi t'i binte një melodie të gëzuar. Ishte hera e parë që Buli gëzohej me të vërtetë.

Të nesërmen e shpuri kecin në shtëpinë e qahajait. Qehajai kishte djegur të dy këmbët duke u munduar të shuante zjarrin. Sarajet e beut ishin bërë si gërmadha. Tërë fshati fliste për trimërinë e kaçakëve. Buli dëgjonte dhe vinte buzën në gaz. Askush s'e dinte që bariu i vogël i beut u kishte treguar kaçakëve hyrjen e fshehtë të sarajeve.

Buli u nis përsëri me dhi. Por ai u betua me vehte se sa të rritej dhe pak, do të delte kaçak e t'u vinte flakën sarajeve të bejlerëve.

PESHQIT E JANIT

Ishte mezi i majit. Shelgjet buzë lumit ishin mbushur me gjethe. Kishte kohë pa rënë shi. Herë herë, në qiell dukej ndonjë re e bardhë që shkonte në drejtim të Jugut. Jani një djalë i vogël dhjetëvjeçar, i dobët po shumë i shkathët, zbriti në lumë. Në një dorë mbante një kallam dhe në tjetrën një kuti me karema. Motra e tij, Eleni, ishte e sëmurë dhe s'kish ç'të hante, prandaj Jani vajti në lumë për të zënë peshk.

Zuri vënd në një shpellë të lartë dhe hodhi grepin në ujët e kthjellët. Hodhi grepin dhe po shikonte me kujdes peshqit që i silleshin rrotull një copë herë.

— Hajeni, hajeni se është i mirë — murmuriste Jani nëpër dhëmbë dhe sytë nuk i shqiste nga karremi. Ndenji ashtu duke pritur një copë herë.

Papritur zëmra filloi t'i rrahë më me for-

cë. Në dorë ndjeu një tronditje. Filloi ta tërhiqte ngadalë filoëspanjën e tendosur. Kur ngriti grepin pa se kishte kapur një alamet ngjale. Kallami u përkul shumë. Ngjala për-pëlitej si e xhindosur, gjersa e këputi fare fillin dhe me të në gojën e gjakosur humbi në ujrat. Janit iu duk sikur iu këput një copë nga zemra e tij.

Lot të nxehtë iu rrukullisën faqeve, la kallamin dhe u mundua të kapte ndonjë peshk me dorë por u lodh kot një copë herë të gjatë. U ul buzë shpellës, i lodhur e i dërmuar dhe vështronte petalet e bardha të qershive që i hidhte era e pranverës mbi valët shkumbëbardha të lumit. Bënte vapë. Në vrimë të një shpelle aty përballë, Jani pa se u fut një zog i bukur. Ai i donte shumë zogjtë aq sa një natë u gdhi përjashta duke kërkuar një fole bilbili, por, atë ditë nuk ja vuri veshin fare. Filloi të bridhte lumit i mërzitur. Nja njëqind hapa më poshtë Jani pa një dalan të ngritur nën një katarakt të vogël. Peshqit hidheshin duke treguar barkun e tyre të argjendë dhe mbeteshin në dalan. Jani hypi mbi shpellë që ta shihte më mirë. Ishte dalani i kryeplakut, që të ngordhte në dru për hiç gjë. Tërë fshati e kishte frikë atë.

— Do të marr ca peshq t'ja çoj Elenit, tha Jani me vete; ajo është e sëmurë dhe nuk ka vënë gjë në gojë. Më fal, o zot, kurrë nuk do të marr gjë pa pyetur.

«Po pse i lutem zotit? — Peshqit të kujt janë, mos vallë i ka hedhur kryeplaku në lumë? Jo! Jo! Ata janë rritur vetë. Pastaj dalanin kryeplaku ja rrëmbeu xha Mihalit. Lumi është i të gjithëve. Kryeplaku do t'i hajë për qejf kurse unë do t'ja çoj motrës së sëmurë.»

Ai iu afrua peshqve dhe me duart që i dridheshin mori pesë prej tyre e i futi në këmbësh e tij të grisur. Hodhi sytë rreth e rrotull. Nuk ndihej asnjë zhurmë përveç gurgullimës së ujit. Jani u fut në mes të degëve të shelgjeve dhe filloi të ngjitej për në fshat. Mbrapa tij ndjeu çape të rënda që e ndiqnin. Një zë i trashë burri e tmeroi:

— Ndalo qerrata, ndalo, pa ta ndreq unë qejfin. Të shohësh ti si vidhen peshqit e kryeplakut.

Në fillim shtangu në vend, pastaj iku me vrap. Këmbët iu gjakosën e iu dërmuan nëpër gurët e mprehtë. Gjunjët iu prenë, kishte dy ditë pa vënë bukë në gojë. Hanin vetëm lak-

ra të ziera dhe ndonjë pikë dhallë nga tri dhitë e dobëta që kishin. Mirrte frymë me zor.

Pranë një gorice të madhe mbi rrugë kryeplaku e përfshiu për qafe dhe e shtyu. Jani ra mbi barin e njomë. Pastaj kryeplaku e kapi prej veshësh e shau dhe përsëri me një pëllëmbë e rrëzoi për tokë e iku. Janit i qe lidhur fare gjuha. Një ngjyrë e verdhë ia kishte mbështjellë tërë trupin e dobët e lakuriq.

Ashtu si nëpër ëndër dëgjoji një zë që i thërriste:

— Jani. . . O Jani.

Ishte Genci, bariu i vogël i fshatit, që ruante dhitë.

— Jani, ngreu vëlla, se iku.

Jani qante në heshtje.

Një ditë më parë, Genci i kish gjetur mullixhiut kecin që i kishte humbur dhe ai i kish dhënë një copë kulaç.

— Na Jani ha, — i tha ai— dhe ja zgjati copën e kulaçit me duar të dredhura.

— Nuk më hahet Genc, nuk më hahet.

— Mos qaj, sa herë më rrahin mua! hajde ngreu të shkojmë bashkë në shtëpi. Nesër merr dhe gjuaj peshq me kallamin tim. Hajde rre-

gulloju ca se nëna do të frikësohet kur të të
shohë kështu.

Jani u ngrit duke u mbajtur tek Genci.
Poshtë këmbëve pa një copë të këmishës së
tij të grisur dhe të pesë peshqit e shkelur me
këmbë nga kryeplaku. Psherëtiti. Shtrengoi
grushtat dhe u largua bashkë me Gencin.

THESARI

Ishte mëngjes vjeshte. Era zvarriste gjithet e rëna të pemëve në tokën e zbutur nga shiu i vjeshtës.

Fshatarët, që sapo kishin nxjerrë bagëtinë nga katojet, panë një re të dendur pluhuri, që ngrihej nga xhadeja nën fshat. Një grup burrash t'armatosur u futën në fshat.

— Ballistët! — thirri dikush.

Dhe fjala u përhap gojë më gojë: — ballistët.

Ata kishin vënë në kokë nga një qeleshe të bardhë, në pjesën e përparme të së cilës dukej një shqiponjë me krahë të shtrira.

— Shikoni, — tha njeri nga fshatarët, — kanë vënë në ballë shqiponjën, spurdhjakët.

Petrua dhe Rakua, dy djem trembëdhjetëvjeçarë, po vilnin bistaqet e fundit të rrushit në vreshtë, po kur panë ballistët, erdhën me vrap në shtëpi.

— Nëno, erdhën ballistët, — thirri Rakua me një frymë.

— Shpejt, fshihi pulat në katua, — i tha gjyshja, — se ata do të na i hanë të gjitha. Na, moj nuse, fshihe edhe atë pak gjalpë që na ka mbetur, se s'lenë vend pa kërkuar ata të mallkuar.

Ballistët u mblodhën në njerën nga klasat e shkollës së fshatit dhe dërguan e thirrën kryeplakun. Kryeplaku, një burrë shtatlartë me sy të skuqur si të ndonjë pianeci, erdhi me një frymë dhe u takua me komandantin e tyre. Rakua dhe Petrua, po i shikonin me vemendje nga larg.

— Këta kanë ardhur të kërkojnë diçka nga kryeplaku, — tha Rakua — shiko si bisedojnë vesh më vesh. E di ç'ke ti Petro, hajde të hypim në tavanin e shkollës, t'i dëgjojmë se ç'do bisedojnë dhe të lajmërojmë partizanët.

Të dy shokët, fshehurazi u futën nga pullazi i shkollës ndën çati dhe mbështetën faqet mbi tavanin e pluhurosur.

— Ej, si qënke nxirë ti Rako!

— Po ti mos ke mbetur më i bardhë?

— Shëëët... erdhën...

Rakua kishte vënë syrin te një vrimë e

vogël në tavan dhe shikonte ç'bëhej në klasën ku ata kishin bërë mësim. Komandanti i ballistëve dhe kryeplaku u ulën pranë e pranë. Rakua dhe Petrua mbajtën frymën, që të mos u shpëtonte asnjë tingull që nxirrnin ata nga goja.

— Ne duam të marrim ato armët që fshehën italianët kur ikën, — i tha komandanti i ballistëve kryeplakut, i cili kishte mbështetur mjekrën mbi pëllëmbë.

— Ato janë fshehur tek mulliri i vjetër. në fund të fshatit, pranë atij lisit të madh që i ka djegur një rën anë rrufeja.

— Mos i di njeri tjetër veç teje?

— Jo. Kur i fshehëm isha vetëm unë me dy ushtarë italianë. Pastaj ata të dy i mora për darkë dhe nuk i lashë të venin gjëkund gjersa i përcolla nga fshati.

Rakua me Petron dëgjonin dhe zemra u rrihte me forcë.

— Do vemi t'i marrim nesër, — i tha komandanti i ballistëve kryeplakut, — do të vish edhe ti me ne.

— Kur jam kursyer unë për ju zoti Selim? Për drekë ju pres nga shtëpia.

— Do vimë, po ki kujdes t'i ndash djemtë e mi nëpër shtëpi të mira dhe porositi

fshatarët që t'i ushqejnë mirë, se ndryshe di unë si t'ua ndreq samarin.

— Pse llafosesh kështu, zoti Selim, fshatarët i duan si djemtë e tyre.

Rakua harroi dhe desh thirri: «Gënjen, fshatarët s'duan t'i shohin me sy këta ndyrësira!» Po Petrua i vuri pëllëmbën në buzë dhe i tha me zë të ulët:

— Pusho i marrë, do që të na pjekin të gjallë?

Kryeplaku dhe Selimi dolën nga shkolla; me ta u bashkuan edhe ballistët e tjerë dhe u shpërndanë nëpër fshat.

Rakua dhe Petrua dolën ngadalë nga vendi ku qenë fshehur dhe vrapuan të lanin faqet në krua. Pastaj u ngjitën të dy te një haur i rrëzuar dhe biseduan me zë të ulët:

— Petro, ne nuk duhet t'ua lemë ballistëve t'i marrin armët. Partizanët kanë shumë nevojë për to. Të vemë sonte natën t'i nxjerrim nga vendi ku janë dhe t'i fshehin te ajo shpella në lumë, që e dimë vetëm ne të dy.

— Mirë Rako, sonte flemë në shtëpinë time. Aty kryeplaku nuk i bie ballistët se e di që nuk ka gjë për të ngrënë. Marrim dhe atë fenerin tim të vjetër dhe bashkë me babanë

dalim sapo t'i zerë gjumi të gjithë. Tani hajde të shkojmë.

* * *

Ishte mezi i natës. Retë e dendura i shtyn-te era dhe rrallë linin të dukej ndonjë yll. Rakua dhe Petrua hapën ngadalë portën e madhe dhe u nisën për tek mulliri i vjetër i fshatit ku i priste babai i Petros, që kishte shkuar më parë. Përreth kudo qetësi. Lart në mal shquheshin nja dy zjarre çobenjsh gjysëm të shuar.

— Rako, e more sqeparin me vete?

— Po, ja ku e kam.

— Po shkrepse?

— E kam futur tek feneri.

Udhëtuan një copë udhë pa folur. Pastaj Rakua i tha shokut:

— Petro, bën ftohtë.

— Të thashë ta vishje trikon.

Të dy vazhduan të ecin në mes të rrugës së ngushtë të fshatit, mbushur me gurë dhe kashtë thekre. Era përkulte lisat e njomë, hijet e tyre herë kryqëzoheshin, herë ndaheshin prap dhe dukeshin sikur i ngjiteshin malit.

— Rako, ke frikë?

— Jo... Po ti?

— As unë.

— Mos nuk e gjejmë dot vendin dhe na vete mundimi kot?

— Mos u bëj merak se do ta gjejmë. Ja ku është ajo hieja e madhe e zezë atje përtej.

Të dy shokët iu afruan mullirit të vjetër gjysëm të rrënuar. Ujët e lumit vazhdonte të hynte në mulli, po mokrra e prishur prej kohe nuk tundej nga vendi.

— Rako, ç'të jetë ajo gjë e zezë atje?

— Mbaje gati sqeparin në dorë.

— Eh, qenka buf dreqi, ç'na trembi.

— Petro, ejani, ky është vendi, u foli fshatari duke u dalë përpara.

Djemtë u afruan te lisi qindvjeçar. Babai filloi të rregullonte fenerin, kurse djemtë po kërkonin me sy nëpër errësirë vëndin ku duhej të gërmonin. Feneri u ndez dhe një dritë e zbehtë shtyu errësirën disa metra. Tani përtej lumit errësira dukej më e madhe. Babai filloi i pari të gërmonte me sqepar dheun e zbutur nga shiu, ndërsa Petrua e Rakua e hiqnin me dorë.

Ajri binte erë lule-dele të thara.

Vonuan kështu nja një orë gjersa Petrua thirri:

— Më zuri dora një gjë të fortë.

— Pa dale, o, qenka dërrasë.

Vazhduan të gërmonin më me vrull dhe pas pak panë kapakun e një arke të madhe.

— Hajdeni ta ngremë të tre, Petro, — tha babai.

Kapaku i madh i arkës kërciti.

— Pooo, poo, — thirrën të habitur djemtë, — ç'revole, ç'pushkë, që qenkan, hajde t'i marrim shpejt dhe t'i fusim te ajo shpella përtej lumit.

Djemtë filluan t'i çonin armët te bregu i lumit gjersa e boshatisën arkën e madhe. Babai e mbylli përsëri kapakun e saj dhe i hodhi tërë dheun përsipër. Pastaj nëpër ujë të tre i çuan armët në bregun tjetër pa i lagur dhe i fshehën në një shpellë që s'binte në sy as ditën me diell. Së fundi Rakua kishte marrë një revole të vogël me dorezë të bardhë dhe po e shikonte.

— Petro, si thua, a e fshehim veç këtë dhe e marrim për vehte?

— Mirë e ke, o Rako, fshihe këtu atë.

Papritur babai thirri:



— Rako, shuaje fenerin, më duket sikur dëgjova zëra njerzish.

Të tre heshtën. Veç buçimës së lumit të rrëmbyeshëm nuk dëgjohej asgjë.

— Ja, pa shiko, atje përtej një dritë, po afrohet në drejtim të lisit ku është fshehur arka.

Pas pak disa burra iu afruan lisit dhe filluan të gërmonin. Ata bisedonin me zë të lartë. Rakua njohu zërin e kryeplakut.

— Hë, dhe pak, djema se nuk është thellë, — u thërriste ai ballistëve.

— Qënkam ballistët.

— Pse të kenë ardhur tani natën?

— Ndofta kanë marrë vesh se po vinë partizanët dhe duan të ikin me natë nga fshati — ua ktheu babai.

— Ashtu do të jetë, sa mirë bëmë që erdhëm shpejt!

— Shiko shiko, tani po e hapin arkën.

Të dy djemtë dhe babai ja qepën sytë dritës së zbehtë që binte mbi arkë.

— Po kjo qenka bosh! — ulëriti njeri prej tyre.

— O zot! — thirri i habitur kryeplaku,

— po si kështu? Mos vallë i ka marrë shejtani nga arka.

— Jo shejtani jo, ti ua ke shitur partizanëve, zoti kryeplak.

— Për Perëndi, zoti Selim, po më bie më qafë kot.

— Ku i ke futur lekët, qafir, se të hodha të vdekur në lumë.

— Zoti Selim, nuk u kam dhënë gjë partizanëve, për kokën e djalit.

— Unë dua armët, ose paratë.

— S'kam gjë... s'kam...

— Lidheni!

— Aman zoti Selim, po me mua sillesh kështu?

— Përpara!

Kur u larguan ata, Rakua dhe Petrua morën frymë lirisht. Ndenjën dhe ca pastaj u nisën për në fshat.

Pa zbardhur dita mirë, nga mali zbriti një skuadër partizanësh. Tërë fshati doli e i priti me gëzim bijtë që luftonin për lirinë e Shqipërisë. Njëri nga fshatarët u tregoi se ballistët ua kishin mbathur këmbëve natën sapo kishin dëgjuar se po vinin partizanët.

Komandanti i skuadrës së partizanëve u

vrenjt në fytyrë dhe i thirri një partizani të shkuar në moshë:

— Xha Ali, nuk patëm fat, s'i arritëm dot, ata do t'i kenë marrë armët me vete.

— Jo, shoku komandant, armët i kemi ne,
— thirri befas Petrua.

— Ju? — tha i habitur komandanti.

— Po, ne me babanë e Petros — u hodh Rakua.

Atëhere babai i Petros tregoi historinë e armëve përpara fshatarëve dhe partizanëve.

— Ju lumtë, djema, ju lumtë! — u tha komandanti dhe i përqafoi të dy, kurse fshatarit i shtrëngoi dorën.

Edhe partizanët e tjerë u gëzuan dhe përqaftuan me radhë Rakon e Petron. Pastaj u nisën për te vendi ku ata kishin fshehur armët për partizanët.

— Po këtu qenka një thesar i vërtetë! — tha i gëzuar komandanti dhe filloi t'u shpërndante armët partizanëve, që mezi prisnin t'i merrnin dhe të luftonin me to armikun e egër.

Më në fund Rakua i tha komandantit:

— Shoku komandant, ne kemi bërë një faj.

— Ç'farë faji?

— Kemi fshehur një revole me dorezë të bardhë dhe nuk jua treguam juve. Ajo nuk na duhet neve po do t'ja falim ndonjë partizani që i pëlqen të mbajë revole.

— Tahir, — i thirri komandanti një partizani të ri, — merre revolen që ëndëroje, ta falën këta pionierë.

Tahiri e fërkojti një herë revolen me duart e tij të ashpëra dhe përqafoi Rakon me Petron.

Pastaj dy djemtë u futën në radhët e partizanëve dhe u ngjitën për në fshat duke kënduar:

— Bashkoju shok, me ne në çetë
Malit të lart t'i shkojm përpjetë
Se atje o shokë kemi foletë
Ne shqipo, shqiponjat partizan'.

PËRMBAJTJE

	Faqe
Te stani në mal	3
Dinamiti	10
Kali im	15
Gjak në dëborë	22
Në mes të pyllit dhe dëborës	29
Bariu i vogël dhe Balashi	35
Peshqit e Janit	41
Thesari	46

REPUBLIKA E SHQETI
SHKURTORI 40400

Tirazhi 6000 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-65

Shtyp N.I.Sh. Shtypshkronjave «Mihal Duri» — Tiranë, 1967